

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7828
E shtunë, 6 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Zgjedhjet në Britani: Laburistët shënojnë fitore bindëse, Sunaku e pranon humbjen



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSH ËSHTË FAJTOR PËR NGECJEN NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI?

FAQE 4-5



Për gati nëntë muaj,
udhëheqësit e Kosovës dhe
ata të Serbisë shkuan vetëm
një herë në Bruksel për

bisedime dhe nuk u takuan
me njëri-tjetrin. Palët
këmbejnë akuza për
moszbatim të marrëveshjeve

të arritura, por kush është
fajtor që procesi për
normalizim të raporteve
Kosovë - Serbi ka ngecur?

KURTI: KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË SË KOSOVËS JANË NË RRITJE

F. 3



IKD-ja: RRETH 113 MIJË LËNDË TË PAZGJIDHURA

F. 5



AKTUALE



KQZ-ja IA HEQ ALFRED BELERIT MANDATIN E KRYEBASHKIAKUT TË HIMARËS

F. 3

ETEJA: KOPJIMI NË PROVIMIN E MATURËS SHETËTËRORE, PROBLEM SISTEMATIK, KRIJON BESIM TË RREMË MBI DIJET E NXËNËSVE

F. 6

NJËSITET ANTIKONTRABANDË TË DOGANËS ZËNË 130 PAKETIME TË BARNAVE PA BANDEROLA

F. 8

EKONOMI



RIZVANOLLI DHE SZUNYOC BISEDOJNË PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË ENERGJISË

F. 8

SHPALLET TENDERI MBI 46.6 MILIONË EURO PËR ZGJERIMIN E RRUGËS PRISHTINË - PEJË, SEGMENTI DOLLÇ - ZAHAQ

F. 8

SPORT



'EURO 2024', SONTE SUPERNDESHJET ANGLI - ZVICËR DHE HOLANDË - TURQI

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zgjedhjet në Britani: Laburistët shënojnë fitore bindëse, Sunaku e pranon humbjen

LONDËR, 5 KORRIK - Partia Laburiste ka arritur fitore bindëse në zgjedhjet parlamentare në Britani të Madhe të premten, duke i dhënë fund qeverisjes 14-vjeçare nga Partia Konservatore.

Laburistët e qendrës së majtë i kanë fituar shumicën e ulëseve në Parlamentin britanik, që përbëhet prej 650 vendesh, ndërsa Partia Konservatore e Rishi Sunakut e ka pësuar disfatën më të rëndë në historinë e vet.

Mëngjesin e së premtes Keir Starmer u zotua se do të sjellë ndryshime në Britani si kryeministri i ardhshëm i vendit. Sunaku e pranoi humbjen më herët dhe tha se i ka telefonuar Starmerit për ta uruar për fitoren. Starmer tha gjatë një fjalimi mëngjesin e së premtes se "ndryshimi fillon tani". "Ne kemi thënë se do t'i japim fund kësaj rrëmuje, dhe do ta bëjmë. Ne kemi thënë se do t'ia nisim nga e para, dhe e kemi bërë. Sot ne e fillojmë kapitullin e ri. E nisim punën e ndryshimeve, misionin e një ripërtëritje kombëtare dhe fillimin e ndërtimit të vendit tonë", tha Starmer.

Ndërkohë, Sunak e mori përgjegjësinë për disfatën e partisë së tij dhe kërkoi falje. "Ka shumë gjëra nga të cilat duhet të mësojmë dhe për të cilat duhet të reflektojmë dhe unë e marr përgjegjësinë për humbjen", tha ai.

Përderisa Britania e ka shmangur

trendin e kthimit nga e djathta që është parë së fundi në Evropë, përfshirë në Francë dhe në Itali, shumë prej rrymave të njëjta populiste paraqiten në Britani.

Udhëheqësi i Reform UK, Nigel Farage, bëri fushatë me mesazhe kundër emigrantëve dhe mori një pjesë të mbështetësve nga konservatorët, të cilët pritej të përballëshin me zhgënjim.

Farage u bë deputet për herë të parë, pasi partia e tij i fitoi katër ulëse në Parlament në zgjedhjet e 4 korrikut.

Britania ka përjetuar disa vite të trazuara - pjesërisht për fajin e konservatorëve - që kanë shkaktuar pesimizëm në mesin e shumë votuesve për të ardhmen e vendit të tyre.

Dalja e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian, pasuar nga pandemia e Covid-19 dhe pushtimi rus i Ukrainës, i dhanë goditje të rënda ekonomisë, ndërsa festat që shpërfillën rregullat e izolimit, të organizuara nga kryeministri i atëhershëm Boris Johnson dhe stafi i tij, shkaktuan zemërim të gjerë.

Pasardhësja e Johnsonit, Liz Truss, tronditi ekonominë edhe më tej me një pako shkurtimesh drastike të taksave, dhe qëndroi vetëm 49 ditë në detyrë.

Sunak, i cili e zëvendësoi Trussin, më pak se dy vjet më parë, shpalli zgjedhjet e 4 korrikut pavarësisht prej sondazheve që parashihnin humbje të partisë së tij. Analistët



vlërësuan se ai e pa arritjen e disa suksesve në ekonomi - sikurse rënia e inflacionit dhe rritja ekonomike - si momentin më të mirë për ta çuar vendin në zgjedhje.

Sunak do t'ia paraqesë zyrtarisht dorëheqjen mbretit sot pasdite. Starmer, si udhëheqës i partisë fituese, do të takohet më pas me mbretin, i cili do t'i kërkojë atij ta formojë një qeveri.

Më pas, kryeministri i ardhshëm

zakonisht shkon në Downing Street për ta mbajtur një fjalim para publikut.

Gjatë ditëve në vijim, udhëheqësi i ri do ta fillojë emërimin e ministrave të qeverisë, duke filluar nga postet e larta dhe duke kaluar në role me më pak përgjegjësi.

Parlamenti pritet ta rinisë punën më 9 korrik. Kryetari i Dhomës së Ulët të Parlamentit do të zgjidhet nga radhët e deputetëve të Parlamentit.

Secili deputet më pas do ta bëjë betimin për besnikëri ndaj mbretit ose do ta bëjë një pohim solem (deklarim se do ta thotë të vërtetën). Kjo procedurë zakonisht zgjat disa ditë.

Hapja e Parlamentit dhe Fjalimi i Mbretit, që përcakton programin e legjislativitetit të qeverisë për seancën parlamentare, priten më 17 korrik, megjithëse kjo datë mund të ndryshohet nga qeveria e ardhshme.

Shefi i NATO-s shpreson se Ukraina do t'i bashkohet aleancës brenda 10 vjetëve

BRUKSEL, 5 KORRIK - Shefi në largim i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se shpreson se Ukraina do të mund t'i bashkohet aleancës ushtarake brenda dhjetë viteve të ardhshme. "Vërtet shpresoj se Ukraina do të bëhet aleate", tha Stoltenbergu duke iu përgjigjur pyetjes për zgjerimin e mundshëm të NATO-s në dhjetë vitet e ardhshme.

Ai u bëri thirrje aleatëve të NATO-s ta furnizojnë Ukrainën me më shumë armë dhe municione për t'i ndihmuar ta mposhtë pushtuesin rus. "Sa më e madhe që të jetë mbështetja, aq më shpejt do të përfundojë lufta", theksoi ai.

Stoltenbergu, të cilit i mbaron mandati më 1 tetor, i bëri këto komente në një intervistë për agjencinë gjermane të lajmeve, DPA, e cila u publikua të premten.

Liderët e NATO-s do të takohen javën e ardhshme në Uashington për ta festuar 75-vjetorin e themelimit të aleancës, ku pritet të njoftojnë



mbështetje të re për Ukrainën. Ukraina është duke trokitur në dyert e NATO-s qysh prej vitit

2008, kur iu premtua se një ditë do të jetë anëtare. Presidenti i Ukrainës,

Volodymyr Zelensky, ndërkohë, ka thënë kohë më parë se Kiev i duhet të ftohet për t'iu bashkuar

NATO-s në samitin e Uashingtonit, pasi dështoi ta marrë ftesën në samitin e 2023-s në Vilnius pavarësisht prej lobimit.

Një prej gjërave kryesore që do të bjerë në sy gjatë këtij samiti është formulimi në deklaratën përfundimtare në lidhje me gjasat e Ukrainës për anëtarësim në NATO.

Përpilimi i këtij dokument, i cili përbëhet zakonisht nga disa faqe, është duke ndodhur tash e disa javë në zyrat qendrore të NATO-s në Bruksel. Por, mospajtimet kryesore kanë të bëjnë me mënyrën e saktë të përshkrimit të gjasave të Ukrainës për t'iu bashkuar aleancës.

Ukraina nuk do të ftohet për t'iu bashkuar NATO-s tash, kjo është shumë e qartë.

NATO-ja ka qenë e prerë se Ukraina nuk mund t'i bashkohet asaj derisa lufta është duke vazhduar, sepse vendet anëtare nuk duan të zhyten në një konfrontim të drejtpërdrejtë me Rusinë.

Kurti: Kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës janë në rritje

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në Kosovë, si vendi më demokratik në Ballkanin Perëndimor, ka rritje të kërcënimeve të sigurisë, sidomos nga sulmi terrorist në Banjskë.

Derisa NATO përgatitet për fillimin e samitit të saj në Uashington të martën, duke shënuar 75 vjet nga themelimi, Kurti rikujton se si NATO është ngulitur në identitetin kulturor dhe politik të Kosovës.

Kryeministri i Kosovës në një opinion të botuar në "The New York Times", me titull "Mos dyshoni në NATO-n, e shpëtoi popullin tim", kujton momentet kur NATO

ka hyrë në Kosovë para 25 vitesh. "Kush nga njerëzit e mi mund ta harronte pamjen e ushtarëve të NATO-s që brohoriteshin teksa mbërritën? Gjatë 25 viteve të fundit, ndërsa NATO ndihmoi në çlirimin e Kosovës dhe ruajti paqen, ne ndërtaam demokracinë për të nxitur këtë paqe nga brenda...", shkruan Kurti.

Kryeministri tutje thekson se Perëndimi duhet të jetë krenar për këtë arritje. "Megjithatë, edhe pse demokracia e Kosovës është në rritje, kërcënimet ndaj sigurisë së saj janë gjithashtu në rritje. Në shtator, trupat paraushtarake serbe

të armatosura rëndë, të cilat ne besojmë se vinin nga Serbia, zunë pozicione në Manastirin Ortodoks të Banjskës, në atë që qeveria e ShBA e quajti një përpjekje shumë të organizuar që përfshinte armë të sofistikuara. Forcat ushtarake serbe u mobilizuan pranë kufirit tonë, një veprim i kritikuar nga Shtetet e Bashkuara si 'destabilizues'. Vitin e kaluar NATO rriti trupat e saj nga 3,770 në rreth 4,500 mes kërcënimeve në rritje për paqen", shkruan Kurti.

Sipas tij, sfidat politike mbeten gjithashtu. "Në vitin 2017, Aleksandar Vuçiq, një ish-ministër i

propagandës nën Millosheviqin, u bë president i Serbisë. Ngritja e tij shënoi një kthim në politikën autoritare, etnonacionaliste të Millosheviqit, veçanërisht në llojin ekspansionist. Politika autoritare e Beogradit ua vështirësoi veçanërisht jetën serbëve etnikë në Kosovë.

Atyre iu desh të luanin rolin e tyre si pakicë në një vend të ri me një popullsi prej përafërsisht 93 për qind shqiptarë etnike dhe 7 për qind të përbërë nga pakica të tjera, duke përfshirë romët dhe turqit. Serbia e ka penguar këtë integrim. U desh trimëri që serbët etnikë t'i

bashkoheshin institucioneve dhe të bëheshin pjesëmarrës aktivë në vend", tha ai.

Kurti në opinionin për "The New York Times" thotë tutje se një front i ri në Ballkan do t'i shërbente Rusisë po aq sa Serbisë. "Serbia mund të përpiqet të fitojë territor përmes agresionit dhe Rusia mund të fitojë një kontroll më të fortë ndaj Serbisë si një satelit, përveçse të shpërqendrojë botën nga lufta që po bën në Ukrainë. Nën drejtimin e Vuçiqit, Serbia ka investuar shumë në bashkëpunimin e saj ushtarak me Rusinë..." thotë ai.



KQZ-ja ia heq Alfred Belerit mandatin e kryebashkiakut të Himarës

TIRANË, 5 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Shqipërisë (KQZ) njoftoi të premten se ia ka hequr Alfred Belerit mandatin e kryetarit të zgjedhur të Himarës, pasi Gjykata e Apelit e mbajti në fuqi dënimin e tij me burgim muajin e kaluar. "Jemi në kushtet e humbjes së mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë dhe e shpallim të pavlefshëm këtë mandat", tha të premten Ilirjan Celibashi, kreu i KQZ-së.

Beleri, me shtetësi shqiptare dhe greke, i fitoi zgjedhjet e majit 2023 si kandidat i opozitës për kryetar të Bashkisë së Himarës - qytet i banuar edhe me popullsi greke në jug të Shqipërisë, shkruan REL. Por, ai u arrestua pak ditë para zgjedhjeve nën dyshimet për blerje votash dhe u dënua me dy vjet burgim në mars. Apeli e konfirmoi dënimin e tij në qershor. Beleri ishte i pranishëm në

seancën që u zhvillua në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të premten. Ai u përcoll nga forcat e policisë nga burgu i Fierit, ku po e vuan dënimin. Ai bëri thirrje që çështja e vlefshmërisë së mandatit të tij të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. "Jam i qartë që mandati im si kryetar bashkie ka mbaruar, por duket qartë arroganca e tyre që t'i bëjnë votimet në gusht. Pse KQZ t'i bashkohet kësaj kërkesë. Kam frikë se gjysma e bashkisë do të verë në burg", tha Beleri.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi ta shqyrtojë vlefshmërinë e mandatit të kryebashkiakut të Himarës pas një kërkesë të dorëzuar nga kryetari i forumit të të rinjve socialistë të Himarës.

Ekipi mbrojtës i Belerit ka një muaj kohë për t'u ankuar ndaj vendimit në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.



Beleri nuk u betua asnjëherë si kryetar i Himarës, pasi ndodhej në paraburgim dhe më pas u dënua. Beleri dhe ekipi i tij i kanë hedhur

poshtë akuzat si "politike dhe të pabazuara". Dënimin e tij nxiti fërkime në mes të Shqipërisë dhe Greqisë.

Ministria e Jashtme e Greqisë tha se "dënimin dyvjeçar është padyshim joproporcional me masën e veprës së supozuar".

Partia e kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis e emëroi pastaj atë kandidat për zgjedhjet për Parlamentin Evropian, të cilat u mbajtën nga data 6 deri më 9 qershor, ku ai u zgjodh deputet.

Zgjedhja e Belerit deputet i Parlamentit Evropian shkaktoi polemika si për legjitimitetin e tij, po ashtu edhe për ndikimin e rastit të tij në integrimin evropian të Shqipërisë.

Juristë dhe ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare thonë se rasti i tij ngre shqetësime kushtetuese dhe ligjore. Sipas tyre, ai mund të ndikojë edhe në përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por edhe në marrëdhëniet e saj me Greqinë.



Kush është fajtor për ngecjen në dialogun Kosovë - Serbi?

Për gati nëntë muaj, udhëheqësit e Kosovës dhe ata të Serbisë shkuan vetëm një herë në Bruksel për bisedime dhe nuk u takuan me njëri-tjetrin. Palët këmbëjnë akuza për moszbatim të marrëveshjeve të arritura, por kush është fajtor që procesi për normalizim të raporteve Kosovë - Serbi ka ngecur?

PRISHTINË, 5 KORRIK - Takimet e mbajtura së fundi në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, qoftë në nivelin e lartë apo në atë të kryenegociatorëve, kanë një emërues të përbashkët: përfundimin pa rezultate konkrete.

Palët, që dialogojnë prej vitit 2011 në ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, vazhdimisht fajësojnë njëra-tjetrën për moszbatim të marrëveshjeve ekzistuese apo për dështim të dialogut, ndërkaq BE-ja ka theksuar se ka mungesë të vullnetit politik për zbatimin e marrëveshjeve.

Kosova dhe Serbia kanë edhe mendime të ndryshme për përfundimin e procesit të normalizimit të raporteve. Kosova kërkon njohje reciproke, ndërkaq Serbia do kompromis ku “asnjëra palë s’do të jetë fituese absolute apo humbëse absolute”.

Marrëveshja e fundit që palët arritën më 2023 ishte ajo për rrugën drejt normalizimit të raporteve - e njohur edhe si Marrëveshja e Ohrit, të cilën Brukseli e konsideron arritje të

madhe.

Kjo marrëveshje që nuk është nënshkruar për shkak të refuzimit të Serbisë parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, si dhe njohjen e ndërsjellë të simboleve shtetërore. Ajo kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t’i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e arritura më herët, përfshirë edhe atë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, themelimin e të cilit Serbia kërkon me ngulm, ndërsa Kosova deri më tani e ka refuzuar.

“Nga normalizimi në menaxhim krizash”

Toby Vogel nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Bruksel, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se dialogu nuk po shënon sukses që shumë vite pasi, sipas tij, përqendrimi është zhvendosur nga arritja e një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme për normalizim, në menaxhim të krizave, që veçmas

shpërthyen vitin e kaluar.

Fajin për ngecjen në dialog ai ua vesh të tria palëve. “Pengesja kryesore vjen nga Serbia”, pohon Vogel, sipas të cilit, Beogradi “nuk dëshiron normalizim, sepse përfiton nga situata aktuale” e pasigurisë. Por, as Kosova, sipas Vogelit, nuk është e interesuar për procesin e dialogut, sepse e di që rruga e saj evropiane “do të jetë e mbyllur për shumë vjet”, pasi normalizimi është vendosur kusht për integrimin evropian për të dyja vendet. “Të dyja palët nuk janë të interesuara për zgjidhje, tash për tash”, thotë Vogel.

E sa i përket BE-së, Vogel konsideron se Brukseli për vite të tëra e ka “keqmenaxhuar” procesin e dialogut. Përderisa janë mbajtur takime në nivel kryenegociatorësh, dialogu në nivel politik ishte joekzistent për pothuajse nëntë muaj. Nga 14 shtatori i vitit 2023 deri më 26 qershor 2024 kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nuk shkuan në Bruksel për një raund bisedimesh.

Në pjesën më të madhe të vitit të kaluar, tensionet ishin të larta: nga protestat e majit, në veri, kundër kryetarëve të rinj shqiptarë të komunave, deri te përshkallëzimi në Banjskë, kur një grup i serbëve të armatosur, të udhëhequr nga Millan Radoiçiqi, sulmoi Policinë e Kosovës. Sipas Vogelit, ngjarjet në maj, por edhe sulmi në shtator, duhej të ishin

“zile zgjimi” në BE për ndryshimin e qasjes në dialog. Vogel thotë se, edhe pas Banjskës, Serbia ka vazhduar të mos përballet me presion, të paktën jo publikisht nga BE-ja, ndërkaq ndaj Kosovës ende janë në fuqi masat ndëshkuese të vendosura për shkak të tensioneve në veri.

Kushtet e Kurtit për dialogun

Në raundin e fundit të dialogut, më 26 qershor, ndonëse ishte paralajmëruar një takim ndërmjet Kurtit dhe Vuçiqit, për të biseduar për Marrëveshjen e Ohrit, BE-ja tha se kryeministri kosovar refuzoi të ulet në një tavolinë me presidentin serb, si dhe vendosi tri kushte për angazhimin e mëtejshëm në proces. Kurti kërkoj të nënshkruhet Marrëveshja e Ohrit nga palët, të tërhiqet një letër e 13 dhjetorit 2023 e ish-kryeministres serbe Ana Bërnabiq - ku Serbia thotë se nuk do t’i zbatojë disa pjesë të marrëveshjes - si dhe të dorëzohet Radoiçiqi dhe grupi i tij nga ana e Serbisë tek autoritetet gjyqësore të Kosovës.

Vogel nuk e cilëson paktin e vitit të kaluar si marrëveshje, për shkak se, siç thotë ai, në letërën e Bërnabiqit, Serbia e pranoi se nuk do të pajtohet me atë që nënkupton njohje de facto të sovranitetit dhe pavarësisë së Kosovës. E kuptimi i normalizimit, sipas tij, është

njohja.

Edhe BE-ja tha më 1 korrik se “konsekuenca logjike e normalizimit do të ishte njohja”. Ky qëndrim i BE-së për Vogelën është sinjal se blloku “e ka pranuar se dialogu nuk po jep rezultate”.

Kushtet e vendosura nga Kurti, Vogel i sheh si të arsyeshme dhe i cilëson si parimore, por thotë se ai është dashur t’i bëjë ato publike para se palët të shkonin në Bruksel. Por, ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, në një intervistë për “Klan Kosovën” më 3 korrik, tha se pret nga Kosova dhe Serbia t’i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e dialogut “pa parakushte” dhe “me urgjencë”.

Ndryshimi i ndërmjetësve

Më vonë, gjatë këtij viti, në BE pritet të ndryshohen udhëheqësit e institucioneve kyçe. Vendin e shefit të diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, pritet ta zërë kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas, ndërkaq në vendin e emisarit të dialogut, Miroslav Lajçak, ende nuk dihet se kush do të vijë.

Përderisa Kurti dhe Vuçiqi po shihen si hezitues për t’i normalizuar raportet, Vogel thotë se me ardhjen e Kallasit, atmosfera në dialog do të ndryshojë, por edhe Serbia duhet të bëhet gati që të përballet me pak më shumë presion nga BE-ja.

IKD-ja: Rreth 113 mijë lëndë të pazgjidhura

PRISHTINË, 5 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka paraqitur raportin "Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm - (Problemet kushtetuese të Projektligjit aktual). Aty u tha se nga të gjeturat e raportit, Projektligji që synon ta rregullojë të drejtën për qytetarët për një gjykim në kohë të arsyeshme ka shumë probleme.

Hulumtuesi i lartë i IKD-së, Gzim Shala, tha se te përgjegjësitë e gjyqtarit, Projektligji ka përcaktuar se "në

rastet e dështimit të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës të veprimit në mënyrën dhe brenda afateve të parapara me këtë ligj përbën bazë për inicim të procedurës disiplinore në pajtim me legjislacionin përkatës për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve".

Shala tha se, sipas këtij neni, gjyqtari mund të mbahet përgjegjës edhe pa fajin e tij. Kjo pasi në rastin konkret, Projektligji nuk i referohet fajit të gjyqtarit, por thjesht "dështimit" për të vepruar

brenda afateve të përcaktuara me këtë ligj. Ai tha se mund të ketë situata, kur gjyqtari ka "dështuar" për t'i trajtuar rastet brenda afateve të përcaktuara me ligj. Por, theksoi se ka mundësi që ky "dështim" të ketë ardhur si rezultat i rrethanave objektive, për shembull, mbingarkesës së tij me lëndë, kompleksitetit të çështjes, mospërgjegjjes adekuate nga ana e institucioneve të tjera e rrethana të tjera.

Shala u shpreh se IKD-ja i rekomandon Ministrisë së

Drejtësisë ta rishqyrtojë nenin 8 të Projektligjit. Në anën tjetër, hulumtuesi u shpreh se edhe neni 19 i cili përcakton se "1. Për të vendosur mbi padinë për kompensim të dëmit lidhur me shkeljen për gjykim të arsyeshëm është Gjykata Supreme" e që, sipas tij, trajtimi i këtyre rasteve rrezikon ta shkatërrojë Gjykatën Supreme. Sipas këtij raporti, Shala tha se rritja e lëndëve deri në fund të vitit 2023 ka arritur kulmin. "Në Gjykatat Themelore mbetën 112 mijë e 623 lëndë të

pazgjidhura", u shpreh Shala. Sipas tij, një kohëzgjatje jo e arsyeshme cenon një prej kompetenteve kyçe të gjykimit të drejtë, e që është gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor, për të cilën tha se IKD-ja në vazhdimësi ka ngritur si shqetësim.

Shala tha se deri tani janë ndërmarrë reforma të rëndësishme për të adresuar këtë problem. Megjithatë, deri tani nuk është shënuar progresi i kërkuar, veçanërisht në fushën civile.



Osmani uron kryeministrin e ri britanik: Do të punojmë ngushtë për ta forcuar aleancën tonë

Prishtinë, 5 korrik - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka uruar kryeministrin e ri të Britanisë së Madhe, Sir Keir Starmer. Osmani në "X" ka shkruar se fitorja e kryeministrit Sir Keir Starmer është fitore historike, transmeton "Telegrafi". "Mbretëria e Bashkuar ka një vend të veçantë në zemrat e të gjithë kosovarëve dhe jam e

bindur që së bashku, ne do të punojmë ngushtë për të forcuar aleancën tonë të gjatë. Ju roj suksese kur merrni këtë rol të rëndësishëm", ka pohuar ajo. Kryeministri i ri i Britanisë së Madhe, Sir Keir Starmer, u është drejtuar turmave në qendër të Londrës pasi Partia Laburiste fitoi në zgjedhjet e përgjithshme të vendit.



Gërvalla priti në takim lamtumirës ambasadorën e Mbretërisë së Holandës, vlerëson lart kontributin e saj

PRISHTINË, 5 KORRIK - Zëvendëskryeministria dhe ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur në një takim lamtumirës ambasadorën e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezoo. Ministria Gërvalla e falënderoi ambasadorën për rolin e saj si ambasadore në Kosovë, për mbështetjen e dhënë gjatë

proceseve jo të lehta për sigurinë në Kosovë dhe rajon si dhe i uroi suksese të mëtutjeshme në misionin e ri. Gjatë këtij takimi, ministria Gërvalla dhe ambasadorja Lobbezoo biseduan edhe rreth progresit të arritur në vitet e fundit nga Republika e Kosovës në zhvillimin e demokracisë, sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik, si dhe në politikën e

jashtme, proceset integruese si dhe fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale me shtete të ndryshme. Ministria Gërvalla vlerësoi lart kontributin e ambasadores për fuqizimin e marrëdhënieve të qëndrueshme në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës si dhe rritjen e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.



ETEA: Kopjimi në Provimin e Maturës Shtetërore, problem sistematik, krijon besim të rremë mbi dijet e nxënësve

PRISHTINË, 5 KORRIK - Rezultatet e provimit në masë të madhe krijojnë një besim të rremë mbi dijet dhe aftësitë e nxënësve, ndërsa edhe këtë vit kopjimi dhe manipulimi në Provimin e Maturës është një problem sistematik, i nxitur nga toleranca dhe inkurajimi i administratorëve dhe mbikëqyrësve. Kështu u tha në "Raportin analitik mbi Provimin e Maturës Shtetërore", të publikuar të premten nga Organizata ETEA, raporton "Ekonomia Online".

Aty u tha se testi i maturës duhet të mbikëqyret me kamera, ndërsa u kërkua edhe ndryshimi i Ligjit për Provimin e Maturës, në mënyrë që të ashpërsohen masat ndëshkimore ndaj administratorëve dhe personave përgjegjës që përfshihen në praktika të kopjimit.

Autori i këtij raporti, Agon Ahmeti, ka thënë se Provimi i Maturës Shtetërore në Kosovë paraqet një hap vendimtar



për nxënësit e shkollave të mesme të larta, duke shërbyer si kriter kyç për vijim të studimeve në institucionet e Arsimit të Lartë (IAL). "Organizata ETEA gjatë pesë viteve të fundit ka observuar organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore duke vënë theksin tek integriteti dhe besueshmëria e rezultateve", ka thënë Ahmeti.

Më tutje ai ka thënë se qëllimi i kësaj analize është t'i identifikojë lëshimet dhe sfidat ekzistuese në organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore, të ofrojë rekomandime për përmirësimin e këtij procesi dhe të nxisë politika arsimore të bazuara në të dhëna për të zhvilluar cilësinë e arsimit në Kosovë. "Nota mesatare e nxënësve

barazohet në përqindje me rezultatet e provimit. Kjo minimizon rëndësinë e vlerësimeve gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme të bëra nga mësuesit gjatë tri viteve. Provimi i Maturës, i cili zgjat 2 orë e 30 minuta, nuk mund ta kapë plotësisht thellësinë dhe gjerësinë e aftësive dhe të njohurive të nxënësve. Rezultatet e provimit në masë të madhe krijojnë një besim të rremë mbi dijet dhe aftësitë e nxënësve. Kopjimi dhe manipulimi në Provimin e Maturës është një problem sistematik, i nxitur nga toleranca dhe inkurajimi i administratorëve dhe mbikëqyrësve", shtoi ai.

Koordinatorja e projekteve në këtë organizatë, Bleona Kurreshi, ka dhënë disa rekomandime për t'i përmirësuar pyetjet e Maturës. "Po flas për disa rekomandime siç janë: fuqizimi i rolit të administratorëve dhe mbikëqyrësve përmes trajnimeve intensive, duke u

fokusuar në ndershmërinë dhe integritetin akademik; Integrimi i teknologjisë së avancuar për mbikëqyrjen e provimit, duke përfshirë përdorimin e kamerave dhe detektorëve të pajisjeve elektronike, pra për ta zvogëluar mundësinë e kopjimit; Përmirësimi i transparencës dhe publikimi i rregullt i raporteve mbi ndëshkimet për shkeljet e rregullave të provimit; Ligji për Provimin e Maturës duhet të rishikohet për t'i ashpërsuar masat ndëshkimore ndaj administratorëve dhe personave përgjegjës që përfshihen në praktika të kopjimit", ka thënë Kurreshi.

Ky raport synon të ofrojë një vlerësim kritik dhe gjithëpërfshirës të procesit të Provimit të Maturës Shtetërore, duke analizuar efektivitetin, integritetin akademik, dhe sfidat kryesore që ndërliken me të gjatë viteve të fundit dhe me fokus në vitin 2024.

Gjykata ua vazhdon paraburgimin edhe për dy muaj të dyshuarve për spiunazh

PRISHTINË, 5 KORRIK - Gjykata ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj dy të dyshuarve për spiunazh, Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi, të cilët ishin arrestuar në fillim të muajit qershor. "Referuar kërkesës tuaj për informata, ju njoftojmë se pas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për vazhdimin e masës së paraburgimit në çështjen penale kundër të pandehurve B.Sh dhe M.Q., Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me datë 05.07.2024 ka marrë aktvendim dhe ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ashtu që masa e

paraburgimit dy të pandehurve iu është vazhduar në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj", thuhet në përgjigjen e Gjykatës Themelore në Prishtinë për "Betimi për Drejtësi". Bedri Shabani bashkë me Qerimin ishin arrestuar për shkak të dyshimit se janë marrë me aktivitete të spiunazhit. Sipas PSRK-së, dy të pandehurit dyshohen se kanë kryer veprën penale "Spiunazhi" nga neni 124, par. 3 i Kodit Penal, ndërsa i pandehuri M. Q. ka kryer edhe veprën tjetër penale "Mbahitja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366, par. 1 i Kodit Penal, si dhe ekziston dyshimi se të pandehurit kishin për t'i kryer veprat penale për të cilat dyshohen.



Prokuroria Speciale e Kosovës e Republikës së Kosovës (PSRK) kishte njoftuar se, pas zhvillimit të hetimeve disamujore, në bashkëpunim me

Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), ka zhvilluar bastisje në dy lokacione të Kosovës dhe ka arrestuar dy persona

me nënshtetësi të Kosovës, B. Sh dhe M. Q., të dyshuar për kryerjen e veprës penale "Spiunazhi".

Policia e Kosovës (PK) përmes raportit 24-orësh ka bërë me dije se në shtëpitë e dy të dyshuarve që u arrestuan të mërkurën për spiunazh u gjetën dhe sekuestruan dokumente të ndryshme, kompjuterë, telefona, USB, DVR, kasete, armë, municione, maska, gazmaska ushtarake dhe shumë dëshmi të tjera. Sipas policisë, arrestimi i të dyshuarve erdhi pasi në bashkëpunim me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe Prokurorinë Speciale janë ndërmarrë veprime hetimore lidhur me dyshimet për spiunazh.

Në kryeqytet fillojnë takimet me qytetarë për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje për 2025-n

Prishtinë, 5 korrik - Në kryeqytet kanë filluar takimet me qytetarë për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje për vitin 2025. "E nisëm me Rrugën 'Muharrem Fejza', ku qytetarët propozuan ide për projekte të rregullimit të

lagjes, si: ndërtimin e një Qendre për të Moshuar, ndërtimin e një fushe sportive, rregullimin e Rrugës Astrit Rrushi dhe të ngjashme. Brenda 14 ditëve, do të mbahet takimi pasues ku qytetarët do të votojnë për

financim të njërit prej këtyre projekteve nga kryeqyteti. Në ndërkohë, ne do të vazhdojmë me takimet e radhës në Sofali dhe Barilevë", ka shkruar në "Facebook" kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



Abdixhiku pret në takim të dërguarin e Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, flasin për zhvillimet në vend

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim të dërguarin e posaçëm të Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, Anzej Franges, i shoqëruar nga ambasadorja e Sllovenisë në Kosovë,

Minca Benedejcic. Në këtë takim kryetari Abdixhiku dhe i dërguari i posaçëm i Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, Anzej Franges, diskutuan për situatën aktuale politike në vend dhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike lidhur me këto

ngjarje. Gjithashtu, u diskutua edhe lidhur me mundësitë e bashkëpunimit dhe thellimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Sllovenisë, vend ky i cili e ka ndihmuar Kosovën në proceset shtetndërtuese dhe zhvillimore.



Pas Hovenierit, edhe Rohde konfirmon mbështetjen: Normalizimi Kosovë - Serbi duhet të rezultojë me njohje reciproke

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ambasadori gjerman Jorn Rohde ka thënë se normalizimi në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë në njohje në rast se të dyja shtetet duan të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. "Normalizimi duhet të rezultojë me njohje nëse të dyja, Kosova dhe Serbia, duan t'i bashkohen BE-së. Shumë shpesh ajo që është etiketuar 'hap pas hapi' rezultojnë në një 'tit for tat' që nuk ndihmon asnjërin palë. Vendimet e guximshme janë shumë të nevojshme!", ka shkruar Rohde në platformën "X".

Shprehja "Tit for tat" e përdorur nga ambasadori përshkruan një situatë të reciprocitetit në veprime, veçanërisht kur dikush përgjigjet në formë hakmarrjeje. Edhe ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, dje në një intervistë televizive ka sqaruar termin "raporte të normalizuara"



në mes të Kosovës dhe Serbisë, meqë thotë se disa njerëz në Kosovë shqetësohen kur e

dëgjojnë të thuhet diçka e tillë nga amerikanët me mendimin se kjo është diçka më pak se ajo çfarë në

të vërtetë është kërkuar përfundimisht. Hovenieri ka thënë se është i

lumtur të sqarojë se një terminologji e tillë s'nënkupton diçka të tillë dhe rithekson se pozicioni i ShBA-së ka qenë i qartë në dy kampet.

Diplomati amerikan ka thënë se qëndrimi i ShBA-së është se rezultati përfundimtar i negociatave në mes të Kosovës dhe Serbisë mund të jetë vetëm njohja e ndërsjellë. "ShBA-ja beson se rezultati përfundimtar i këtij procesi mund të jetë vetëm njohja reciproke", ka thënë Hovenieri në "Klan Kosova".

Ambasadori amerikan ka thënë se për këtë çështje e shpreh me mjaft bindje qëndrimin amerikan. Takimet e mbajtura së fundi në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, qoftë në nivelin e lartë apo në atë të kryenegociatorëve, kanë një emërues të përbashkët: përfundimin pa rezultate konkrete.

Ligjvënësit premtajnë më shumë përkrahje për Onkologjinë, renovimet shihen si shpresë për pacientët

PRISHTINË, 5 KORRIK - Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka vizituar të premten Klinikën e Onkologjisë në QKUK, ndërsa renovimet e bëra në këtë klinikë u panë si shpresë për pacientët. E ligjvënësit e Kosovës premtuan më shumë përkrahje, teksa lista e pritjes e mungesa e barnave u konsiderua probleme. Kryetarja e këtij komisioni, Fatmire Kollçaku, ka thënë se është bërë një punë dhe kontribut i madh për përmirësimin e kushteve në këtë klinikë.

Drejtori i Onkologjisë, Ilir Kurtishi, ka thënë se kushtet për pacientet janë përmirësuar dukshëm dhe, sipas tij, nuk mungojnë shërbimet esenciale dhe nuk ka nevojë të dilet jashtë vendit për trajtim. Gjithashtu, ai ka njoftuar se tashmë është bërë promovimi i sistemit laserik C-RAD të gjurmimit optik 3D, duke e bërë kështu këtë institucion të vetmin në rajon me këtë teknologji të avancuar.

Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Elvir

Azizi, ka thënë se do të mundohet që t'ua plotësojnë sa më shumë kushtet pacientëve.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Zemaj, ka potencuar se ka ndryshime por, sipas tij, janë të pamjaftueshme, edhe pse shpenzimet nga buxheti shtetëror janë milionëshe.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Bekim Haxhiu, ka theksuar se, përkundër projektligjit për çmimet e barnave, ende ka rritje të çmimeve dhe ka mungesë të tyre.



Njësitet Antikontrabandë të Doganës zënë 130 paketime të barnave pa banderola



PRISHTINË, 5 KORRIK - Në Prishtinë Njësitet Antikontrabandë të Doganës së Kosovës, pas pranimit të informatës nga qytetarët për prani të barnave pa banderola, kanë kryer një kontroll në një barnatore. Si rezultat, janë gjetur të

fshehura 130 paketime të barnave të ndryshme me banderola të shteteve të huaja, të cilat janë kontrabanduar në Kosovë. "Malli i kontrabanduar është sekuestruar dhe ndaj palës është iniciuar procedura kundërvajtëse.

Falënderojmë qytetarët për bashkëpunimin dhe i inkurajojmë të gjithë të raportojnë çdo aktivitet të dyshimtë për ta mbrojtur shëndetin publik dhe ekonominë tonë", ka njoftuar Dogana.

Rizvanolli dhe Szunyog bisedojnë për zhvillimin e sektorit të energjisë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe zëvendësministri Getoar Mjeku kanë pritur në takim ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE), Tomas Szunyog. Gjatë takimit ministria Rizvanolli dhe ambasadori Szunyog diskutuan për zhvillimin ekonomik të Kosovës, për

mbështetjen e sektorit të energjisë dhe menaxhimin e mbeturinave. Ministria Rizvanolli e falënderoi ambasadorin Szunyog për përkrahjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian po i jep Kosovës, veçanërisht në zhvillimin e sektorit të energjisë dhe e njoftoi për prioritetet e

Ministrisë së Ekonomisë në fushën e burimeve të ripërtërishme të energjisë: energjisë nga era dhe asaj solare. Ambasadori Szunyog ka shprehur gatishmërinë e Bashkimit Evropian për ta vazhduar përkrahjen për Kosovën në zhvillimin e sektorit të energjisë.



176 familje të Podujevës kanë përfituar investime në efikasitet të energjisë



PODUJEVË, 5 KORRIK - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka zhvilluar takim me drejtorin e Fondit Kosovor për Efikasitet të Energjisë (FKEE), Driton Hetemi.

Gjatë këtij takimi është diskutua për punën e deritanishme që ka kryer FKEE-ja në komunën e Podujevës dhe projektet e radhës ku mund të investohet.

Deri më tash FKEE-ja ka përfunduar pesë projekte dhe pesë të tjera pritet të zbatohen sivjet.

Me projektin e efikasitetit të energjisë sivjet do të investohet në objektin e komunës së Podujevës në instalimin e paneleve solare, në IAAP "Isa Boletini", ShFMU "Ali Ajeti" Lladoc, ShFMU "Hamit Sejdiu" Kërpimeh dhe ShFMU

"Shefki Kuleta" Tërnavë.

Në të gjitha objektet shkollorë do të bëhet izolimi termik i mureve dhe kulmi, ndërrimi i dritareve, përmirësimi i ndriçimit, përmirësimi i sistemit të ngrohjes dhe ujit sanitar.

Nga viti i kaluar nga FKEE-ja individualisht kanë përfituar 176 familje të Podujevës investime në efikasitet të energjisë në vlerë 705 mijë euro, kurse shuma totale e mbështetjes në projekte të ndryshme nga FKEE për komunën e Podujevës dhe qytetarët është 2.3 milionë euro. Kryetari Bulliqi e falënderoi Hetemin për mbështetjen dhe u pajtuan që ky bashkëpunim veçse të thellohet me qëllim të realizimit të sa më shumë projekteve në komunën e Podujevës.

Shpallet tenderi mbi 46.6 milionë euro për zgjerimin e rrugës Prishtinë - Pejë, segmenti Dollc - Zahaq

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shpallur tenderin për zgjerimin e rrugës nacionale Prishtinë - Pejë, përkatësisht segmenti Dollc - Zahaq. Vlera e parashikuar për katër lloje të këtij tenderi është 45 690 000 euro.

Njoftimi për kontratë për tenderin që planifikohet të zgjasë tri vjet apo 36 muaj është publikuar më 04.07.2024, ndërsa më 05.02.2024 në platformën e-prokurimi ishte publikuar njoftimi paraprak.

Për shpalljen e tenderit mbi 40 milionë euro është përdorur procedura e hapur, ndërsa kriter për dhënie të kontratës është çmimi më i ulët. Sipas dosjes së tenderit, vlera e parashikuar për lot 1 është 10 687 000 euro, për lot 2 është 11 970 000 euro, për lot 3 - 12 515 000 euro dhe për lot 4 - 10

518 000 euro. Afati i fundit për pranim të tenderëve është 29.07.2024, kur edhe do të bëhet hapja e tenderëve.

Edhe për një segment tjetër të rrugës Prishtinë - Pejë, më 25.03.2024, ishte nënshkruar kontrata. Për segmentin Kijevë - Dollc ishte nënshkruar kontrata në vlerë 21 milionë euro.

Vitin e kaluar, më 22.11.2023, Qeveria e Kosovës kishte miratuar vendimin për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9 Kijevë - Zahaq, Segmenti Kijevë - Dollc, Zona Kadastrale: Kijevë, Komuna Malishevë dhe Zonat Kadastrale: Çabiq, Zabërgjë, Gllarevë, Dresnik, Gremnik dhe Dolle të komunës së Klinës.



Ministri i Bujqësisë: Për herë të parë pas luftës sigurojmë bukën e motmotit

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë të premten se për herë të parë pas luftës Kosova siguron bukën e motmotit. Peci në një video të publikuar në "Facebook" ka shkruar se në Novolan të Vushtrrisë do ta fillojnë zyrtarisht fushatën e korrijeve

shirjeve për këtë vit. "Të dhënat nga terreni tregojnë se fatbardhësisht për herë të parë në historinë e Kosovës së pasluftës ne sigurojmë bukën e motmotit", ka shkruar Peci. Ai ka thënë se një angazhim i tillë është falë përkrahjes së qeverisë, punës së zellshme të fermerëve

dhe begatisë prej Zotit.

Ministri i Bujqësisë më tutje ka thënë se kjo është edhe një tregues i qartë se me angazhim të sinqertë dhe punë meritore nuk ka objektivi që nuk arrihet. "Zoti e bekoftë bukën e Kosovës! Zoti e bekoftë popullin e Kosovës!", tha ai.



Kamala apo Michelle?

“Me një nënë indiane dhe një baba xhamajkan, prokurorja e qarkut Kamala Harris i ngjan një versioni Kalifornian të Barack Obamës,” shkruante gazeta “Los Angeles Times” në tetor 2004, një muaj përpara zgjedhjes së Obamës në Senat: dymbëdhjetë vjet më vonë, gjykatësja Harris u bë senatore, kandidoi më pas në 2019 dhe u mund, në zgjedhjet paraprake demokrate për Shtëpinë e Bardhë. Dhe në vitin 2020 ajo u bë zëvendës-presidentja e parë femër, me Joe Biden si president.

Sot është ajo, 60 vjeçe pas tre muajsh – nga një fëmijë që shoqërohej me autobus në shkollat e integruara me nxënës të bardhë, e rritur hindu, e konvertuar në kishën baptiste, e fejuar me ish-kryebashkiakun e San Franciskos Willie Brown, i cili i ofronte konsulencën të majme 400,000 dollarëshe, tashmë e martuar me avokatit Douglas Emhoff – në krye të grupit të pasardhësve të supozuar të Bidenit, nëse presidenti i moshuar do të dorëzohej para atyre që i kërkojnë një hap historik prapa.

Në të shtunën e premtimeve, shantazheve, ëndrrave, ambicieve, iluzioneve, investimeve, nepotizmit, ideologjive që e shndërrojnë Partinë Demokratike në Leopard të Amerikës, komentuesit pro-republikanë të Wall Street Journal distilojnë helme, duke sugjeruar që rrethi i Biden-it sheh tek Kamala Harris, trashëgimtarë e drejtpërdrejtë për të trembur votuesit e moderuar, duke e detyruar shtabin elektoral të riemërojnë udhëheqësin e moshuar

në Konventën e gushtit në Çikago. Harris kishte debutuar duke akuzuar Bidenin se kishte kundërshtuar integrimin e detyruar të shkollave në vitet 1960, “autobusin” e debatuar, fëmijët e bardhë në geto dhe studentët me ngjyrë në qendër të qytetit, “kur unë isha një vajzë e vogël në ato autobusë”; më pas miqësia me Beau Biden, djalin e madh të presidentit që vdiq në vitin 2015, i kishte pajtuar. Tani zëvendës-presidentja po studion fushatën e New York Times kundër Biden, ajo vëren se Nancy Pelosi po bën thirrje për një kandidat tjetër, ajo e di se rregullat do t’i caktonin asaj thesarin e 264 milionë dollarëve fonde të fushatës dhe që asnjë paditës tjetër nuk mund t’i pretendojë.

Sondazhet nuk e favorizojnë Kamala Harrisin, provat e errëta mbi emigracionin dhe kontrollin e Senatit, kur u nda 50 me 50 me opozitën republikane dhe ishte ajo, zëvendës-presidentja, e cila kishte votën vendimtare, nxjerrin zbuluar plogështinë e saj. Megjithatë, tradita militante e “Klubit të Qenve të Verdhë” – e evokuar nga presidenti Lincoln në 1848 – do të mbledhë gjithësesi votues që nuk e braktisin kurrë partinë. Prandaj, miliona “qen të verdhë” demokratë do të kundërshtojnë Donald Trumpin, kushdo që do të përballlet me të, qoftë flokëbardhi Biden, qoftë Harris, qoftë guvernatori simpatik i Kalifornisë Gavin Newsom, ai i Illinoisit J.B. Pritzker, trashëgimtar i një dinastie sipërmarrësish, qoftë guvernatori i Michiganit Gretchen Whitmer.



Pastaj është një emër i adhuruar në Evropë, i përkëdhelur nga talk show-t liberalë, i mohuar fuqishëm nga ish-presidenti Obama, i mohuar absolutisht nga njoftimet zyrtare për shtyp, i cili gjithashtu, në një sondazh të Reuters/Ipsos të martën, godet fort Trumpin, me një avantazh të madh 50 për qind me 39 për qind, duke shtuar në tufën e votuesve besnikë, “qentë e verdhë”, mbështetjen e grave, të moderuarve, të pavarurve. Ajo është Michelle LaVaughn Robinson Obama, e cila mbush 60 vjeç në janar, juriste që ka studiuar në Princeton dhe Harvard, me dy vajza, Malia dhe Sasha, me një paraardhëse skllave në plantacionet e Jugut. Elegante, sportive, e dashur,

metodiste protestante, profesioniste, Zonja e Parë e bashkëshortit të saj Barack, Michelle Obama nuk ka fituar kurrë zgjedhje. A do të ishte në gjendje të përballonte arsenalin e fyerjeve dhe insinuatave seksiste që Trump do t’i rezervonte asaj nga podiumi, siç bëri me Hillary Clintonin? Një fushatë parandaluese dezinformimi ka nisur në internet përmes Instagramit, e cila falsifikon fotot e Obamës si student me një mik, duke pretenduar se Michelle ka ndryshuar seks dhe ka qenë burrë kur ishte e re. Nëse përmenden, këto shpifje do të bëheshin virale, sipas një raporti konfidencial nga Departamenti i Shtetit, me mbështetjen e qeverive armiqësore, nëpërmjet Inteligjencës Artificiale.

Kamala apo Michelle? Apo një nga guvernatorët e rinj dhe të njohur? Apo veterani Joe, i zgjedhur në Senat në vitin 1972? Beteja politike po i përçan demokratët, të cilët nuk kanë qenë në një kuvend të hapur që nga viti 1968, edhe atëherë në Çikago. Koha po ikën, fondet e bllokuara do të jenë problem, Trump dominon në internet, në mitingje, në Gjykatën e Lartë. Gjithsesi, kushdo që vendoset në gusht, do të jetë në gjendje të mbështetet në dy pasione të pamohueshme: dashurinë e “qenve të verdhë” për demokratët dhe urrejtjen e brendshme, që gjallëron gjysmën e Amerikës kundër Donald Trumpit. A do të mjaftojnë? / La Repubblica – Bota.al

Joe Biden, strategjia e daljes

Ai po mendon nëse duhet të largohet. E shkruajti fillimisht New York Times dhe më pas e konfirmoi CNN, sipas të cilit Presidenti Biden u tha aleatëve të ngushtë se ai po vlerëson nëse mund ta shpëtojë fushatën e tij të rizgjedhjes, apo nëse ka ardhur koha për të bërë një hap prapa. Për të mirën e Amerikës, e cila duhet të jetë para interesit të tij, përballë rreziqeve që një rikthim i Donald Trumpit do të sillte për vetë mbijetesën e demokracisë në Shtetet e Bashkuara. Shtëpia e Bardhë dhe fushata elektorale e mohojnë: “Është e pavërtetë”. Por nën-presidentja Kamala Harris do të ishte zëvendësuesja e natyrshme, megjithëse nuk mungojnë ata që kërkojnë rihapjen e procesit të emërimit, për të lejuar kandidatët e tjerë.

Shenjat e para se diga mbrojtëse e Bidenit po plasaritej erdhën të martën, kur kongresmeni demokrat nga Teksasi Lloyd Doggett theu heshtjen e kolegëve, duke i kërkuar atij të jepte dorëheqjen nga kandidimi. Kryetarja Emeritus Nancy Pelosi tha se ishte legjitime të ngriheshin pyetje në lidhje me kushtet shëndetësore të presidentit, ndërsa kongresmeni i Karolinës së Jugut William Clyburn, i cili e lançoi presidentin drejt Shtëpisë së Bardhë katër vjet më parë, komentoi se në



rast të tërheqjes, ai do të mbështeste zvpresidenten.

Edhe ish-presidenti Obama ka shprehur privatisht shqetësimet që ish-këshilltarët e tij, nga Ben Rhodes te Jon Favreau, i kanë shprehur publikisht, duke pranuar se debati katastrofik në Atlanta mund të ketë komprometuar garën. Sipas CNN, të paktën 25 deputetë do të ishin gati të dilnin hapur, nëse Joe nuk bën një hap prapa brenda një jave, ndërsa New York Times zbuloi se momentet e vështirësive konjitive të presidentit, janë shumë më të shpeshta nga sa dimë.

Ndërkohë, financierët janë ankuar te lideri i mbledhjes së fondeve elektorale, guruja i Hollivudit, Jeffrey Katzenberg, duke kërcënuar se do të

mbyllin rubinetat nëse nuk jepen përgjigje të qarta, ndërkohë që edhe sondazhet kanë filluar të përkeqësohen. Reuters e vendos Biden në të njëjtin nivel me Trump, të dy me 40% në nivel kombëtar, por nënvizon se Michelle Obama do të bënte shumë më mirë se ai, duke fituar 50% me 39%. CBS është më e pamëshirshme, sepse e sheh Donaldin përpara në të gjithë vendin, 50% me 48%, por edhe më mirë në shtetet kyçe, 51% me 48%. Në fund të ditës erdhi konstatimi alarmant i New York Times, sipas të cilit Trump kaloi përpara me 49% kundrejt 43%, ndërsa 74% e amerikanëve e konsiderojnë kreun e Shtëpisë së Bardhë shumë të moshuar për të vazhduar

udhëheqjen e vendit.

Përballë kësaj rënieje të mbështetjes, sipas gazetës, Biden i ka thënë në mirëbesim një aleati të ngushtë se po shqyrton nëse do të vazhdojë apo jo fushatën e ditët e ardhshme do të jenë vendimtare. E rëndësishme do të jetë intervista që ai do të regjistrojë me George Stefanopoulos të ABC-së, mitingjet e fundjavës në Wisconsin dhe Pensilvani dhe konferenca për shtyp në skajet e samitit të NATO-s javën e ardhshme.

Dje presidenti u përpoq të konsolidonte pozicionin e tij, duke ngrënë drekë me zëvendësen Kamala Harris dhe duke zhvilluar dy telefonata me stafin e fushatës dhe të Shtëpisë së Bardhë. Pasdite ai priti guvernatorët demokratë, mes të cilëve kishte shumë zëvendësues të mundshëm, si ai i Kalifornisë Newson, Whitmer i Michiganit, Pritzker i Illinoisit, Shapiro i Pensilvanisë, Moore i Marylandit, Beshear i Kentakit. Qëllimi ishte t’i bindte që të mos e braktisin, por edhe të maste pulsën për dezertime të mundshme. E njëjta gjë vlen edhe për bisedën që bëri me drejtuesit e parlamentit.

Shumë kandidatë të mundshëm heshtin – dhe Harris betohet për besnikërinë e saj – sepse ata nuk duan të digjen dhe ndoshta do të

preferonin të kandidojnë në vitin 2028, kur Trump do të detyrohet nga Kushtetuta të tërhiqet, duke supozuar se ai do e respektojë. Por në prapaskenë, shqetësimi po rritet dhe jo të gjithë duket se janë të gatshëm të dorëzohen para rrezikut të kthimit të Shtëpisë së Bardhë tek Donaldi.

Nuk është rastësi që rivali republikan dhe fushata e tij kanë heshtur deri tani. Menaxheri Chris LaCivita tha në Atlanta se ata ishin të gatshëm për çdo eventualitet, por sipas Washington Post ata janë të shqetësuar për mundësinë e tërheqjes së Bidenit, sepse kjo do t’i detyronte të ndryshonin strategjinë. Ardhja e një kundërshtari më të ri do të vinte në pah më pas ndryshimin e gjeneratës. Dhe kjo do të fokusonte vëmendjen tek moshë e Trumpit, duke e bërë atë një problem.

Sipas zëdhënësës së Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre, presidenti “pati një mbrëmje të keqe në Atlanta për shkak të një të ftohti dhe lodhjeje nga udhëtimet në Francë dhe Itali”. Më pas, “ai personalisht mohoi se po mendon të tërhiqet”. Ai i përsëriti stafit: “Unë nuk po largohem. Do të garoj deri në fund”. Por ndoshta nuk varet më vetëm prej tij. / La Repubblica – Bota.al



Spanja dhe Franca në gjysëmfinale, eliminojnë Gjermania dhe Portugalia



SHUTTIGART, 6 KORRIK - Spanja dhe Franca janë gjysëmfinalistët e parë në "Euro 2024", derisa sot (e shtunë) mësohen edhe dy gjysëmfinalistët e dytë ku përballen Angli-Zvicër dhe Hollandë-Turqi. Spanja arriti një triumf dramatik 2-1 pas 120 minutash ndaj Gjermanisë vendase, pasi koha e rregullt u mbyll në barazim 1-1. Ishte një ndeshje spektakolare, ashtu siç pritej, e cila dhuroi emocione të mëdha. Spanjollët e filluan ndeshjen me një ritëm të lartë, duke dominuar në 45 minutat e para, por rastet nuk munguan as te Gjermania me Havertz. Ekipi i de La Fuentes festoi në minutën

e 50-të, kur Olmo ndëshkoi Neuer në brendësi të zonës, pas një topi të dhënë nga Yamal. Gjermania shtoi presionin dhe zhvendosi kundërshtarit në gjysmefushën e vetë. 3 minuta nga fundi i kohës së rregullt, talenti i hedhur në pjesën e dytë, Wirtz çoi peshë zemrat e tifozëve në fund, goli i tij dërgoi sfidën në shtesë. Më pas sfida ishte e mbushur me raste të shumta, por duelin e vendosi Merino me një gol shumë të bukur me kokë në minutën e fundit të shtesës, duke i dhënë fund aventurës së Gjermanisë në shtëpinë e tyre. Toni Kroos mbyll karrierën brilante me "pancerat".

Ndërkohë Francë-Portugali ishte ndeshje e cila shkoi te penalltitë, ku Franca triumfoi. Koha e rregullt dhe shtesa përfunduan me rrjeta të paprekura. Në pjesën e dytë, luzitanët u zgjuan duke rritur presionin në fushë. As shtesa nuk caktoi një fitues në Hamburg dhe gjithçka u zgjidh nga goditjet e 11 metërshit. Aty Gjelat ishin më të saktë duke fituar 5-4. I vetmi që e humbi penalltinë nga luzitanët ishte Joao Felix. Franca tashmë do të përballlet me Spanjën në gjysmefinale, e cila arriti të eliminonte më herët Gjermaninë në minutat e fundit të kohës shtesë.

SHKURT

Ballkani zyrtarizon ish-sulmuesin e Shkupit

Ballkani ka njoftuar zyrtarisht për transferimin e sulmuesit Sunday Adetunji, Adetunji, i cili ka lënë një gjurmë me shkathtësitë e tij të shquara dhe aftësitë e golave, pritet të kontribuojë në forcimin e sulmit të Ballkanit. Me një karrierë të suksesshme në vitet e fundit, Adetunji ka treguar konsistencë dhe aftësi të jashtëzakonshme në shënimin e golave. Klubi i Ballkanit vazhdon të angazhohet në forcimin e skuadrës për sezonin e ardhshëm, duke synuar të rrisë konkurrencën dhe performancën në nivelin e lartë të futbollit vendor.

Xhaka luan ndaj Anglisë

Granit Xhaka do të luajë kundër Anglisë në çerekfinalen e EURO 2024-shtit të shtunën. Kapiteni i Zvicrës është ndër lojtarët më të spikatur të këtij Evropiani, duke e udhëhequr Zvicrën deri në këtë pikë me performancat e tij vendimtare. Sidoqoftë, ai këto ditë dyshohet për një lëndim të muskullit ngjitës, mirëpo tani gjithçka është qartësuar pasi ka skanuar atë pjesë të trupit. Ky po që është stinori i karrierës së shqiptarit të Zvicrës që sivjet po ashtu bëri histori me klubin e tij, Bayer Leverkuseni.

Kroos: Kjo ëndërr tashmë është shkatërruar, largohem me kokën lart

Mesfushori i Gjermanisë, Toni Kroos luajti sonte ndeshjen e fundit, pasi do të tërhiqet. "Ishte një lojë ku të gjithë vendosëm gjithçka në fushë. Ishim shumë afër. Kjo e bën atë edhe më të hidhur". "Për momentin, dalja nga turneu e tejkalon atë. Të gjithë së bashku kishim një qëllim të madh. Kjo ëndërr tashmë është shkatërruar deri diku. Edhe pse kemi luajtur një turne të mirë. Ne të gjithë mund të jemi krenarë. Jam i lumtur nëse mund të ndihmoj sadopak Gjermaninë në futboll dhe të pretendojmë sërish", ka thënë ai pas humbjes 2-1 ndaj Spanjës në Evropian.

Zaniolo, lojtar i ri i Atalantas

Atalanta ka konfirmuar zyrtarisht arritjen e marrëveshjes me klubin turk, Galatasaray, për transferimin e italianit Nicolo Zaniolo. Fituesi i Ligës së Evropës këtë sezon po dëshiron të përforcoj skuadrën për sezonin e ri, pasi synim i vetëm është të vazhdoj konkurrimin për trofe. Kështu, klubi nga Bergamo ka kompletuar një transferim të madh. Bëhet fjalë për sulmuesin anësor, Zaniolo. Zaniolo së fundmi ishte te Aston Villa, por nën pronësi të Galatasarayt, me të cilët Atalanta ka arritur marrëveshje huazimi me opsion dhe detyrim blerje. "Atalanta BC ka kënaqësinë të njoftojë se ka blerë nga Galatasaray SK - në mënyrë të përkohshme deri më 30 qershor 2025, me të drejtë opsioni dhe detyrim për blerje përfundimtare me paraqitjen e disa kushteve - paraqitjet sportive të futbollistit Nicol Zaniolo", thuhet në njoftim. Huazimi do t'i kushtojë Atalantas 6.4 milionë euro, 2 milionë euro bonuse dhe 15.5 milionë euro klauzolë si opsioni blerjeje të përhershme.

Trajneri i Zvicrës, Anglisë: Jemi skuadër e madhe me të mëdhatë

BERLIN, 6 KORRIK - Numri një i pankinës së Zvicrës, Murat Yakin iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve, në prag të ndeshjes me Anglinë. "Nuk e dimë se çfarë po përgatit Anglia për ne,

por kemi shumë cilësi, jemi në formë dhe të sigurt. Tashmë kemi treguar se mund të krijojmë probleme për të mëdhenjtë, si kundër kampioneve në fuqi 'Italia' dhe

'mikpritësve' të Gjermanisë: do të jetë njësoj ndaj Anglisë", ka thënë Yakin. "Po e shijojmë këtë moment, jemi të lumtur dhe punojmë së bashku drejt të njëjtit qëllim. Po sikur të jetë

ndeshja më e rëndësishme e karrierës sime? Tashmë më kanë kërkuar këtë tri herë, shpresoj të më pyesni edhe dy herë përpara se të largoheni nga Gjermania", ka shtuar Yakin.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 05.07.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike

T-24-10

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani

E-mail: behxhetnimani@hotmail.com

Telefoni: +381 28 538 050

Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e objekteve Depoja e elektromakinërisë 1 dhe Depoja e elektromakinërisë 2 në Njësinë Biznesore Industria Kimike
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

1. Njësia Biznesore Industria Kimike

1. Çmimi fillestar

Njësia Biznesore: Industria Kimike						
Data: 05.07.2024	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar(m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Depoja e elektromakinërisë 1	62.00	2.54	0.46	3.00	186.00
2	Depoja e elektromakinërisë 2	78.00	2.54	0.46	3.00	234.00

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë

Data e shpalljes: 05.07.2024

Sqarimi: deri me 23.07.2024

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 23.07.2024
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Origjinali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 23.07.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneksi 1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneksi 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1

OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e qerasë për sipërfaqen e mbuluar

a	Sipërfaqe e pa mbuluar m2	
b	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) pa TVSH	
c=b*18%	TVSH e çmimit për meter katrorë m2 në (€)	
d=b+c	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) me TVSH	
e=a*d	Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)	
e=c+d	Për pagesë në (€)	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 23.07.2024 deri në orën 11.00 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

Aneksi 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asetë jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E OBJEKTIT

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me operatorin "Sharr Cem" Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 30.07.2024, në ora: 10:00, në hapësirat e LAB (Laboratori për Aktivitete të Biznesit), Rr. Adem Jashari, Nr. 218, 71510, Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga operatori "Sharr Cem" Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Taulant Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

Lendrim Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan KK Gjakovë nga kl. 1-9.

Veli Fetahu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën sh.m Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L